



RAPORTI I PROGRESIT VJETOR **2017**

SHQIPËRIA




Sekretariati Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse

QERSHOR 2018



PARATHËNIE



Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse EITI (Extractive Industries Transparency Initiative) është një koalicion ndërkombëtar vullnetar i qeverive, kompanive që operojnë në industrinë nxjerrëse dhe organizatave të shoqërisë civile të angazhuara në administrimin dhe përdorimin e burimeve natyrore. Aktualisht EITI është Koalicioni i 51 vendeve dhe synon optimizimin e shfrytëzimit të Burimeve Natyrore (Minerare, Hidrokarbure dhe Hidroenergjinë) dhe ka për qëllim promovimin e Transparencës për të parandaluar korrupsionin, si dhe t'i sigurojë qytetarëve një bazë zyrtare dhe të azhornuar për të kërkuar informacionin lidhur me përdorimin e drejtë të të ardhurave.


Shqipëria është një ndër 51 vendet anëtare të Nismës për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse. Shqipëria u bashkua si kandidat e EITI-t në Maj 2009 dhe fitoi statusin e plotë të anëtarësisë në Maj 2013. Që prej aderimit fillestar Shqipëria ka publikuar raporte vjetore duke filluar nga viti fiskal 2009 deri në vitin 2016, dhe së shpejti raportin për vitin 2017.

Raporti i Progresit Vjetor paraqet në mënyrë të detajuar aktivitetet e Sekretariatit Kombëtar EITI për vitin 2017.

Ky vit, ishte i rëndësishëm për ecurinë e punës së Sekretariatit, marrë në konsideratë edhe faktin që më datë 1 Prill 2017 ju nështruar procesit të Validimit nga Sekretariati Ndërkombëtar EITI.

Nga 28 kapituj të shqyrtuara nga Validuesi, në 14 kapituj Shqipëria shënoi ecuri mjaft të mirë, në 13 kapitujt shënoi ecuri të mjaftueshme dhe vetëm në 1 kapitull është vlerësuar pa progres. Në konkluzion të procesit të Validimit Bordi Ndërkombëtar EITI vlerësoi aktivitetin EITI në Shqipëri me Progres Domethënës.

Progresi i bërë në aktivitetin EITI në Shqipëri është shumë pozitiv, dhe në të njëjtën kohë i ngarkon Grupet e interesit me përgjegjësi më të madhe për ruajtjen e këtij standardi dhe përmirësimin e mëtejshëm të tij.



Rikonfigurimi i Ministrive në Kabinetin Qeveritar Rama 2, në muajin Shtator 2017 solli ndryshime të drejtuesve, ku Z. Ardit Kamberi u emërua si Drejtuesi i ri i Sekretariatit Shqiptar EITI dhe Kryetari i ri i Bordit EITI (MSG) u caktua z. Enis Aliko, Zëvendësministër në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Prioritetet kryesore të Sekretariatit Shqiptar EITI janë si më poshtë:

Bashkëpunimi ndërmjet Grupeve të Interesit në Nismën EITI dhe MSG

Sekretariati Kombëtar EITI Shqipëri, institucioni që administron në mënyrë interaktive procesin EITI në Shqipëri, ka synimin të garantojë zhvillimin e një procesi gjithëpërfshirës, konstruktiv dhe transparent. Grupi Ndërinstitucional i Punës (MSG) është organi vendimmarrës, i ngarkuar për mbikëqyrjen e zbatimit të EITI-it.

Në Shqipëri, MSG drejtohet nga Zëvendësministri i Ministrisë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe përbëhet nga përfaqësues të qeverisë (MIE, AKBN, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Ministria e Drejtësisë (dhe aktorë të tjerë të rëndësishëm, të cilët janë kontribues të përhershëm të proceseve EITI), Kompanive që operojnë në industrinë nxjerrëse dhe Shoqërisë Civile.

MSG-ja si organi që miraton Planin e Punës EITI, ka siguruar që EITI të kontribuojë në debatin publik dhe ka mbështetur punën e Sekretariatit Kombëtar EITI Shqipëri.

Raporti Zyrtar Vjetor EITI

Raportit Zyrtar Vjetor EITI përgatitet nga Administratori i Pavarur dhe publikimi zyrtar i Raportit EITI 2016 ka dalë në mes të muajit Shkurt 2018, duke u fokusuar në promovimin e Transparencës dhe Mirëadministrimin e Burimeve Natyrore të vendit.

Raporti zyrtar vjetor EITI publikohet në format lehtësisht të aksesueshëm për publikun, me të dhëna të besueshme dhe të një cilësie të lartë.

Miratimi i Ligjit për Transparencën

Aktualisht EITI është në procesin e miratimit të Draft Ligjit "Për transparencën e veprimtarive të industrive nxjerrëse dhe shfrytëzimit të burimeve natyrore në Republikën e Shqipërisë". Qëllimi i këtij ligji është të nxisë dhe sigurojë rritjen e transparencës në veprimtaritë e industrive nxjerrëse në veçanti, dhe shfrytëzimit të Burimeve Natyrore në përgjithësi, përmes zbatimit të standardeve ndërkombëtare EITI.



Publikimi i Përfituesve Realë (BO)

Ndonëse në Shqipëri aktualisht ekziston Ligji nr. 9917, miratuar më 19 maj 2008 për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, i cili bën thirrje për shtrirjen e këtyre termave tek kompanitë që punojnë në Industrinë Nxjerrëse, në Janar të vitit 2017, në zbatim të Standartit EITI 2016, Sekretariati Shqiptar EITI publikoi një raport mbi analizën e kuadrit legjislativ dhe rregullator kombëtar (Legal and Regulatory Review of the Albanian national legislative framework Report) dhe draftoi ligjin EITI, i cili përmban dispozita për BO. Qeveria aktualisht po punon për miratimin e këtij ligji.


Gjithashtu, në 1 janar të vitit 2017, si të gjitha vendet zbatuese të EITI-t, publikoi udhërrëfyesin për Pronësisë Reale (BO Roadmap) që tregon hapat që ne planifikojmë të ndërmarim që të arrijmë një transparencë të mirëfilltë të Pronësisë Reale deri në vitin 2020. Kjo përfshin ndërtimin e një kuadri institucional dhe ligjor, duke vënë në vendin e duhur proceset e raportimit dhe regjistrat që mbajnë të dhënat e pronësisë reale. Ai përfshin ndërtimin e kapaciteteve për zyrtarë qeveritarë që zbatojnë kërkesat e raportimit. Gjithashtu përfshin rrugën se si kompanitë mund të zbulojnë lehtësisht pronarët e tyre dhe të ndihmojë shoqërinë civile për të përdorur informacionin e pronësisë.

Marrëdhëniet me NJQV për të ardhurat nga Renta dhe Impakti Social e Mjedisor


Gjatë vitit 2017 Sekretariati Kombëtar, zhvilloi takime me përfaqësues të pushtetit lokal, ku u diskutuan dhe përfitimet financiare që Bashkitë kishin marrë ose jo nga renta minerare dhe mbi domosdoshmërinë që këto të ardhura të përdoren për investime publike. Gjithashtu në këto takime u diskutua edhe për Impaktin Social dhe Mjedisor që Industrinë Nxjerrëse kanë në këto zona.

Një Vlerësim i përgjithshëm i performancës vjetore

(Kronologjia e Aktiviteteve kryesore të Sekretariatit EITI në vitin 2017)



- Nga rëndësia që ka për procesin e implementimit të EITI-t në Shqipëri, draftimi i Ligjit “Për transparencën e veprimtarive të industrive nxjerrëse dhe shfrytëzimit të burimeve natyrore në Republikën e Shqipërisë”, Sekretariati Kombëtar EITI organizoi në një takim, më datë 31 Janar 2017 anëtarët e MSG-së. Në këtë takim kompania e kontraktuar Eurosupport-Fineurop Support S.r.l bëri një prezantim të Studimit mbi analizimin e kuadrit legjislativ dhe rregullator kombëtar Shqiptar



në zbatim të Standardeve EITI. Në kuadër të qëllimit të mësipërm kontraktori kishte draftuar Projekt-Ligjin për Transparencën.


Qëllimi i këtij ligji është të nxisë dhe sigurojë rritjen e Transparencës në veprimtaritë e industrive nxjerrëse në veçanti dhe shfrytëzimit të burimeve natyrore në përgjithësi, përmes zbatimit të standardeve ndërkombëtare EITI.

Gjithashtu, në këtë takim, Administratori i Pavarur (IA), Deloitte Audit Albania prezantoi draft Raportin EITI 2015 dhe u diskutua rreth pagesave të rakorduara deri në atë moment.

- Raporti Final Zyrtar EITI 2015 u publikua më datë 1 Shkurt 2017. Gjithashtu, gjatë vitit 2017 ka vijuar intensivisht puna për finalizimin e Raportit EITI 2016.
- Në datën 27 Shkurt, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile në bashkëpunim me Sekretariatit Kombëtar EITI organizuan një Tryezë të rrumbullakët "Transparenca dhe llogaridhënia në industrinë nxjerrëse në Shqipëri". Kjo tryezë diskutimesh mes Sekretariatit dhe Shoqërisë Civile, të organizuar për herë të parë në vend, kishte si qëllim krijimin e themeleve për bashkëpunim mes organizatave të Shoqërisë Civile dhe Sekretariatit, për të intensifikuar dialogun mes dy aktorëve të rëndësishëm me ndikim në rritjen e transparencës në industrinë nxjerrëse. Bashkëpunimi i vazhdueshëm mes EITI Albania dhe organizatave të Shoqërisë Civile konsiderohet thelbësor në përmbushjen e misionit të vetë EITI-t dhe vazhdon të mbetet një nga objektivat kryesore të Sekretariatit në vijim.


Me organizatat pjesëmarrëse, gjatë takimit, u diskutua mbi mënyrat se si mund të nxitet angazhimi aktiv i organizatave të shoqërisë civile në konceptimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e procesit të rritjes së transparencës në industrinë nxjerrëse. Faktorët ligjorë apo rregullatorë të cilët paraqesin pengesa dhe vështirësojnë pjesëmarrjen e lirë dhe aktive të shoqërisë civile në zbatimin e misionit të EITI ishin pjesë e rëndësishme e diskutimeve.

- Në muajin Mars 2017, Sekretariati nisi një fushatë prezantuese të Raportit EITI 2015 në rrethet Patos, Fier, Bulqizë, Pogradec. Grupi i Punës i Sekretariatit, zhvilloi takime me përfaqësues të pushtetit lokal, ku u diskutuan dhe përfitimet financiare që Bashkitë kishin marrë ose jo nga renta minerare dhe mbi domosdoshmërinë që këto të ardhura të përdoren për investime publike.
- Takime të ngjashme u zhvillua edhe në shkollat e mesme në këto Bashki, ku u fol për Nismën EITI dhe përfitimet që ka komuniteti nga EITI. Gjatë takimit u diskutua mbi rolin që duhet të luajnë të rinjtë në komunitet në lidhje me këtë nismë.

- 
- Më 21 Mars 2017, në kuadër të rritjes së bashkëpunimit mes kompanive operuese në vend, MSG-së dhe Sekretariatit EITI, u bë I mundur organizimi i një tjetër aktiviteti të rëndësishëm në dobi të transparencës në Industrinë Nxjerrëse. Sekretariati Shqiptar EITI në bashkëpunim me Antea Cement Sh.A., organizuan mbledhjen e radhës të MSG-së në ambjentet e kompanisë Antea Cement në Borizanë të Krujës. Në këtë takim me pjesëmarrësit u ndanë edhe disa nga arritjet e Antea Cement ndër vite si dhe u njohën me Raportin e Integruar të Përgjegjësisë Sociale dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, që Antea Cement publikon çdo vit, për palët e interesit në kuadër të politikave transparente. Në vijim u zhvillua një vizitë e shoqëruar e anëtarëve të MSG-së dhe Sekretariatit në ambientet e punës, si dhe në karrierat e çimentos për të parë konkretisht shfrytëzimin e minierës dhe veçanërisht rehabilitimin e mjedisit.
 - Në 31 Mars 2017, në vazhden e rritjes së bashkëpunimit mes kompanive operuese në vend, Sekretariati Shqiptar EITI organizoi një tryezë të rrumbullakët me përfaqësues të Operatorëve të Industrisë Nxjerrëse në Shqipëri. Përfaqësues të kompanive kryesore që operojnë në industrinë nxjerrëse në Shqipëri, diskutuan lidhur me problematika të ndryshme të fushës si dhe mbi masat që duhen marrë në mënyrë që të krijohet një mjedis i përshtatshëm për veprimtarinë e këtyre kompanive, duke përmirësuar kuadrin ligjor, plotikat fiskale dhe duke pasur një bashkëpunim më të ngushtë mes kompanive dhe institucioneve shtetërore.

Takimi u përqëndrua më së shumti mbi nivelin e transparencës në industrinë nxjerrëse dhe bashkëpunimin mes institucioneve shtetërore dhe kompanive që operojnë në këtë fushë, si dy pikat kyçe për zhvillimin e këtij sektori. Në këtë tryezë u diskutua mbi rëndësinë dhe funksionin e EITI Shqipëri duke u ndalur në publikimin e të dhënave financiare dhe pagesave në sektorin e industrisë nxjerrëse.

- Në datën 22 Prill 2017, në Tiranë, u zhvillua Workshop-i me temë "Mbi procesin e anëtarësimit të Kosovës në EITI" i organizuar nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik të Republikës së Kosovës dhe shoqëria civile kosovare KFOS. Me ftesë të organizatoreve në këtë takim ishin pjesëmarrës koordinatorët e Sekretariatit EITI Albania, nga të cilët u trajtua tema "Përvoja dhe sfidat shqiptare për në EITI" e lidhur me eksperiencën shqiptare për anëtarësimin në EITI dhe plotësimin e kërkesave të Standartit. Në përfundim u vlerësua nevoja për një bashkëpunim të mëtejshëm mes strukturave të qeverisë të Kosovës dhe Sekretariatit Shqiptar EITI, me synimin e promovimit të Kosovës për tu integruar në procesin ndërkombëtar EITI.

- 
- Sekretariati Kombëtar EITI në periudhën 05-09 Qershor 2017 priti Misionin e Validimit nga Sekretariati Ndërkombëtar EITI me qëndër në Oslo. Procesi i Validimit për Shqipërinë nisi në datën 1 Prill 2017 dhe u finalizua në 13 Shkurt të vitit 2018.

Nga 28 kapituj të shqyrtuara nga Validuesi, në 14 kapituj Shqipëria shënoi ecuri mjaft të mirë, në 13 kapitujt shënoi ecuri të mjaftueshme dhe vetëm në 1 kapitull është vlerësuar pa progres. Në konkluzion të procesit të Validimit Bordi Ndërkombëtar EITI vlerësoi aktivitetin EITI në Shqipëri me Progres Domethënës.


- Në 23-24 Tetor 2017, Qeveria e Indonezisë dhe Sekretariati Ndërkombëtar EITI organizuan, Konferencën Ndërkombëtare për Përfituesit Realë/Beneficial Ownership, në Jakarta të Indonezisë, në një përpjekje globale për të luftuar shmangien e taksave dhe korrupsionin. Në këtë Konferencë morën pjesë përfaqësues nga 52 shtete, për tu angazhuar dhe diskutuar mbi hapat e nevojshme që duhen ndërmarrë në transparencën për Përfituesit Realë të kompanive në industrinë e naftës, gazit dhe minerareve. Në këtë Konferencë, Shqipëria mori pjesë me delegacionin e saj me përfaqësues nga Sekretariati Kombëtar EITI Shqipëri dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Përveç pjesëmarrjes në sesionet plenare, përfaqësuesit e delegacionit shqiptar zhvilluan takime shumëpalëshe, ku u diskutua mbi eksperiencën e Shqipërisë dhe ecurinë e saj në zbatimin e Standartit EITI.

Gjatë konferencës u zhvilluan disa workshop paralele, të fokusuara mbi tematika specifike si: Si të përcaktohen personat e ekspozuar politikisht dhe deklarimi i pasurive; Si qeveria dhe shoqëria civile të punojnë sëbashku për të nxitur transparencën për Përfituesit Realë; Si të ndërtojmë një Regjistër të Përfituesve Realë; Si të përdoren dhe analizohen të dhënat e Përfituesve Realë; Si të krijojmë një kuadër ligjor dhe rregullator për transparencën e Përfituesve Realë, në të cilën kishte pjesëmarrës dhe nga delegacioni Shqiptar, etj.

Si pjesë e angazhimit në këtë Nismë globale dhe në funksion të publikimit brenda vitit 2020 të Përfituesve Realë, Shqipëria në Janar të vitit 2017 ka publikuar Udhëzuesin për hapat që do të ndiqen dhe është duke draftuar projektligjin për Transparencën në të cilin janë përfshirë parashikime për Përfituesit Realë.


- Në muajin Nëntor 2017, Drejtori i Sekretariatit Kombëtar Shqiptar të Iniciativës Globale për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse (AlbEITI) z. Ardit Kamberi, realizoi një Takim me mediat dhe Gazetarë të News 24, Ora News, Monitor, Panorama.

Duke ju përgjigjur pyetjeve të gazetarëve, ai theksoi rëndësinë e misionit të Sekretariatit Kombëtar EITI, i cili promovon Transparencën në procesin e monitorimit për mirëadministrimin e burimeve



natyrore të vendit, në përputhje me Standartin ndërkombëtar EITI. Gjithashtu, theksoi prioritetet e Sekretariatit Kombëtar EITI, duke u ndalur në promovimin e Transparencës për të parandaluar Korrupsionin, Sigurimin ndaj qytetarëve të një baze të dhënash të azhornuar zyrtare për të kërkuar përdorimin e drejtë të të ardhurave kombëtare, me synimin dhe kontributin për Rritjen ekonomike, Zhvillimin e qëndrueshëm dhe Impaktin pozitiv social dhe mjedisor.

- Një element i ri në aktivitetin e Sekretariatit Kombëtar EITI është pjesëmarrja këtë vit e Shqipërisë në një Projekt Pilot, të organizuar nga Sekretariati Ndërkombëtar, mbi transparencën në Tregëtimin e Lëndëve të Para (Commodity Trading) të realizuara nga industritë nxjerrëse me kapital shtetëror, në rastin tonë Albpetrol Sh.a. Projekti është i financuar nga Sekretariati Ndërkombëtar EITI në Oslo i cili ka kontraktuar kompaninë Deloitte Audit Albania për projektin.
- Në 6 Dhjetor 2017, nga ana e Sekretariatit Kombëtar EITI, u organizua një Takim pune në ambjentet e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, lidhur me procedurat e përgatitjes përfundimtare të materialit të Raportit Vjetor EITI 2016.
- Në takim morrën pjesë Zëvendësministri dhe njëkohësisht Kryetari i MSG; Sekretariati Kombëtar EITI, si dhe përfaqësues të Drejtorive të linjës në MIE, përfaqësues të Institucioneve në vartësi, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN), Shërbimit Gjeologjik Shqiptar (SHGSH), si dhe përfaqësues të Administratorit të Pavarur, Deloitte Audit Albania, i kontraktuar nga Sekretariati EITI për përgatitjen e Raportit Vjetor EITI 2016. Organizimi i këtij takimi kishte në fokus diskutimin lidhur me kërkesat e Administratorit të Pavarur Deloitte Audit Albania, në lidhje me problematikat e hasura në mbledhjen e të dhënave EITI, të raportuara zyrtarisht nga Drejtoritë përkatëse të MIE, si dhe AKBN-së, SHGSH-së etj.
- Në datat 20-21 Dhjetor 2017, Sekretariati Shqiptar EITI në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, organizuan Konferencën Ndërkombetare me temë "Shfrytëzimi i Potencialeve dhe Avantazheve të Shqipërisë si vend anëtar i EITI Ndërkombëtar"/ "Taksat dhe kuadri ligjor i industrive nxjerrëse-rasti i Shqipërisë dhe praktikat më të mira ndërkombëtare". Në këtë Konferencë Ndërkombetare ishin të pranishëm Zëvendësministri i Infrastrukturës dhe Energjisë z.Enis Aliko, Drejtoresha e Bankës Botërore në Tiranë znj. Maryam Salim, z.Ervin Mete, Drejtor Kabineti i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si dhe Përfaqësues të OSCE, UNDP, Ambasadës Amerikane dhe Ambasadës Zvicerane në Tiranë. Po ashtu, në event merrnin pjesë shumë përfaqësues të Partnerëve Ndërkombëtarë, Institucioneve Financiare, Ekspertë Ndërkombëtarë në fushën fiskale dhe legale, përfaqësues të Institucioneve Qëndrore, Përfaqësues nga MFE, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Tatimeve, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Agjencia




Kombëtare e Burimeve Natyrore, Albpetrol, Albgaz, TAP, Shell Albania, përfaqësues të Biznesit kryesisht të Industrive Nxjerrëse, si dhe përfaqësues të Shoqërisë Civile dhe anëtarët e MSG të Sekretariatit EITI.

Gjatë Konferencës u transmetua një video mesazh nga Drejtuesi i Sekretariatit Ndërkombëtar EITI, z. Jonas Moberg, ku në fjalën e tij theksoi se duhet vijuar me raportimin më të plotë të ecurisë së projektit TAP, me përmirësimin e monitorimit dhe planifikimit në komunitetet ku shfrytëzohen burimet natyrore, si dhe transparenca duke filluar nga identifikimi i Pronarëve Real të kompanive që operojnë në industrinë nxjerrëse. Z. Moberg, lidhur dhe me procesin e Validimit vlerësoi progresin që ka bërë Shqipëria.

Në fjalën e saj, Drejtoresha e Bankës Botërore në Shqipëri znj. Salim vlerësoi nivelin e bashkëpunimit dhe të angazhimit të Shqipërisë në procesin EITI.

Në event diskutuan përfaqësues të Biznesit të Industrive Nxjerrëse, si kompania Shell Albania, Antea Cement; Drejtues të Dhomës Amerikane të Tregëtisë, Përfaqësues të Shoqatës së Investitorëve të Huaj (FIAA), Përfaqësues të Shoqërisë Civile; Përfaqësues të botës Akademike dhe Shkencore, Drejtorë Drejtorish në MIE, Drejtues të AKBN, Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, Albpetrol, Albgaz; Ekspertë Ndërkombëtarë, Përfaqësues të Deloitte Audit Albania, etj.

- Në datën 20 Dhjetor Eventi i Konferencës Ndërkombëtare u shoqërua edhe me një Ekspozitë Fotografike, në të cilën u evidentuan shumë aspekte dhe pamje nga aktiviteti në sektorët Minerarë, Hidrokarbur dhe Elektro-Energjitik në Shqipëri. Qëllimi i kësaj Ekspozite ishte që të sjellë në vëmendjen e publikut dhe grupeve të interesit, shfrytëzimin e potencialeve të Industrisë Nxjerrëse, si dhe mbi efektin e saj në jetën sociale dhe ekonomike të vendit.



Vlerësimi i performancës kundrejt objektivave dhe aktiviteteve të përcaktuara në Planin e punës të Sekretariatit EITI Shqipëri



OBJEKTIVI Raporti EITI 2016

- Në funksion të kërkesave të Administratorit të Pavarur Deloitte Audit Albania, në lidhje me problematikat e hasura në mbledhjen e të dhënave EITI, të raportuara zyrtarisht nga Bizneset si dhe disa institucione shtetërore, MSG vendosi shtyrjen e publikimit të Raportit EITI 2016 në muajin Shkurt 2018.

OBJEKTIVI VALIDIMI


- Sekretariati Kombëtar EITI në periudhën 05-09 Qershor 2017 priti Misionin e Validimit nga Sekretariati Ndërkombëtar EITI me qëndër në Oslo, Norvegji. Validimi është një element thelbësor i procesit EITI dhe shërben si një mekanizëm i jashtëm dhe i pavaruar vlerësimi. Validimi në Shqipëri filloi në datën 1 Prill 2017.

Fillimisht procesi ka filluar me fazën e mbledhjes së të dhënave e cila ka vijuar deri në fund të muajit Maj 2017.

Misioni i Validimit përbëhej nga z. Alex Gordy, Drejtori Përgjegjës për Validimin dhe znj. Oliana Valigura, Drejtuese për Vendet e Euroaziatike. Misioni u takua me antarët e Grupit Ndërinstitucional të punës (MSG- qeveria, kompanitë, dhe shoqëria civile) si dhe me aktorë kryesorë që nuk marrin pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë në MSG.

Sekretariati Kombëtar EITI ftoi të gjitha palët e interesuara të bëheshin pjesë e këtij procesi shumë të rëndësishëm për ecurinë e punës së vetë Sekretariatit.

Në 5 Qershor 2017, Grupi Ndërinstitucional i Punës dhe Sekretariati Ndërkombëtar EITI zhvilluan takimin e tyre të parë, në kuadër të procesit të Validimit për Shqipërinë. Ky takim i parapriu takimeve që u zhvilluan me secilën prej palëve të interesuara (qeveria, kompanitë nxjerrëse dhe shoqëria civile) deri në datë 9 Qershor 2017.



Misioni i Validimit pas takimeve, ka punuar dhe ka dërguar në fund të shtatorit Draft Raportin Fillestar të Validimit dhe Draft Raportin e Validimit nga Validuesi i Pavarur. Të dy raportet i janë shpërndarë MSG-së për komente.

Gjithashtu, në këtë Raport është lënë një listë rekomandimesh strategjike që mund ta ndihmojnë Shqipërinë të përdorë edhe më shumë EITI-n si instrument për të mbështetur reformat.

Nga Raporti Final i Validimit i ardhur në Sekretariat në datë 15. 11. 2017, Shqipëria ka bërë Përparim Domethënës në përmbushjen e kërkesave të EITI-t.

Komiteti i Validimit ka shqyrtuar Raportin Përfundimtar të Validimit dhe dokumentacionin mbështetës (duke përfshirë komentet e MSG-së, Administratorit të Pavarur dhe Sekretariatit Kombëtar EITI Shqipëri). Komiteti i Validimit i ka rekomanduar Bordit të EITI-t për pajtueshmërinë e Shqipërisë me kërkesat e EITI-t.

Bordi i EITI bëri përcaktimin përfundimtar që kërkesat janë plotësuar dhe ra dakort për pajtueshmërinë e përgjithshme të vendit në përputhje me dispozitën 8.3.a.ii të Standardit EITI.

Bordi EITI në datë 13. 02. 2018, ka marrë vendimin që Shqipëria ka bërë Progres Domethënës në zbatimin e EITI-t. Gjithashtu Bordi EITI ka lënë disa Rekomandime të cilat duhet të zbatohen deri në datën 13. 02. 2019.

OBJEKTIVI *Shqyrtimi ligjor dhe Rregullator*

- Aktualisht EITI Albania është në procesin e miratimit të draft Ligjit “Për transparencën e veprimtarive të industrive nxjerrëse dhe shfrytëzimit të burimeve natyrore në Republikën e Shqipërisë”. Qëllimi i këtij ligji është të nxisë dhe sigurojë ritjen e transparencës në veprimtaritë e industrive nxjerrëse në veçanti dhe shfrytëzimit të burimeve natyrore në përgjithësi, përmes zbatimit të standardeve ndërkombëtare EITI, të përmirësojë kuadrin ligjor për raportimin EITI duke e harmonizuar atë me Standardin EITI.

Gjithashtu, në këtë Draft Ligj janë përfshirë dispozita ligjore për deklarimin e Përfituesve Realë/ Beneficial Ownership.



OBJEKTIVI **Zgjerimi i Kapaciteteve EITI**

- Një pikë shumë e rëndësishme për vitin 2017 ka qënë dhe trajnimi i Burimeve Njerëzore duke e konsideruar si një aset shumë të rëndësishëm në procesin EITI. Në këtë kuadër u ndërmorr dhe trajnimi në Columbia University, në New York, USA në datat 03- 18. 06. 2017 dhe 31.07. 2017- 10. 08. 2018, dhe në Universitetin e Huston-it GEDS, Texas, USA, datë 06- 28. 05. 2018, i përfaqësuesve nga Sekretariati Kombëtar EITI, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Albgaz dhe antarë të MSG-së, të cilët shprehën interesin e tyre për të qënë pjesë e këtyre trajnimeve.

OBJEKTIVI **Aktivitete Komunikimi**

- Në Janar të viti 2017, Sekretariati Kombëtar EITI lidhi marrëdhënie kontraktuale përkatësisht me kompanitë Source One, IQ Consulting, si dhe z. Enio Civicin në Statusin e Ambasadorit EITI.
- Kompania Source One dhe Sekretariati Kombëtar EITI, lidhën një Kontratë për "Fushatën e ndërgjegjësimit publik referuar strategjisë së komunikimit (fushatë në median e shkruar dhe vizive, internet dhe median sociale) e cila përfshin organizimin e 2 Konferencave për shtyp për raportin EITI 2015 dhe 2016; printimin e Raportit EITI 2015 dhe Raportit EITI 2016; printimin e përmbledhëses së Raportit EITI 2015 dhe 2016; testimin e spotit të vjetër EITI Albania në Tiranë dhe rrethe; prodhimi i spoteve televizive, 7 dhe 45 sekonda; fushatë në televizione (kombëtare dhe lokale); fushatë në media elektronike; fushatë në shtyp revista Monitor; komunikim i vazhdueshëm i sponsorizuar në mediat sociale; përgatitjen në format elektronik i buletinit periodik informativ nga agjencia; puna përgatitore për ekspozitën fotografike EITI dhe çelja e ekspozitës.

Aktivitet e komunikimit janë realizuar thuajse të gjitha, përveç printimit të Raportit EITI 2016; printimin e përmbledhëses së Raportit EITI dhe 2016. Sekretariati Kombëtar EITI ka amenduar kontratën dhe këto aktivitete do të realizohen gjatë vitit 2018.

- Kompania IQ Consulting dhe Sekretariati Kombëtar EITI, lidhën një Kontratë për organizimin e një Tryeze të rumbullakët me operatorët e industrisë nxjerrëse; organizimin e një Tryezë të rumbullakët me organizatat e Shoqërisë Civile dhe organizimin e një Konference Ndërkombëtare EITI. Të treja këto aktivitete janë realizuar brënda afateve të vendosura në kontratë.

- Z. Enio Civici dhe Sekretariati Kombëtar EITI lidhën një kontratë për të përfaqësuar EITI Shqipëri, si Ambasador EITI, në dy takime me gazetarët ekonomik; për të moderuar Tryezën e rumbullakët me organizatat e shoqërisë civile; për të moderuar Tryezën e rumbullakët me operatorët e industrisë nxjerrëse; për të moderuar Konferencën për shtyp për Raportin EITI 2016; për të mundësuar vazhdimësinë e komunikimit në median sociale, facebook; për përgatitjen e 6 kronikave televizive; përgatitjen e 7 kryeartikujve në shtypin e shkruar dhe atë online.

Aktivitetet janë realizuar në përputhje me kontratën. Ambasadori ka moderuar Konferencën për shtyp për Raportin EITI 2016 dhe ka përgatitur e dy kronika dhe tre editorial të lidhura me përfundimin dhe publikimin e Raportit EITI 2016 që do të publikohet në Shkurt 2018.

Vlerësimi i performancës kundrejt kërkesave EITI

Kërkesa	Progresi
<p>1. Kërkesa EITI 5.3</p> <p>Menaxhimi i të ardhurave dhe shpenzimeve</p> <p>Grupi ndërinstitucional i punës ka për detyrë të bëjë publike çdo informacion të mëtejshëm në lidhje me menaxhimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, përfshirë: a) Një përshkrim të të gjitha të ardhurave nga industria nxjerrëse të alokuara për rajone gjeografike ose programe të caktuara. Ai duhet të përmbajë një përshkrim të metodave që garantojnë llogaridhënie dhe efikasitet në përdorimin e tyre. b) Një përshkrim të buxhetit të vendit dhe proceseve të auditimit si dhe linket ku mund të gjenden informacione të disponueshme publikisht për buxhetin, shpenzimet dhe raportet e auditimit. c) Të dhëna në kohën e duhur nga</p>	<p>Të ardhurat e mbledhura nga Buxheti Shtetit nga industria nxjerrëse bashkohen me të ardhurat e tjera në buxhet dhe alokohen natyrshëm nëpër zërat e buxhetit. Nuk ka alokim specifik të këtyre të ardhurave në programe të buxhetit me përjashtim të Rentës Minerare ku 5% i kalon pushtetit vendor sipas zonave ku ushtron aktivitetet industria nxjerrëse. Njëkohësisht këto të ardhura përbëjnë rreth 5% të Buxhetit.</p> <p>AKBN menaxhon vetë një pjesë të të ardhurave nga Marrëveshjet Hidrokarbure. Deri tani AKBN nuk ka dhënë informacion se si alokohen këto të ardhura në buxhetin e saj.</p> <p>Shteti shqiptar mbledh të ardhura nga sektori i naftës dhe gazit nëpërmjet ndarjes së prodhimit të naftës, bonuset, rentën minerare, tatimit mbi fitimin dhe dividend, të ardhura nga punësimi. Në raport tregohet shpërndarja e të ardhurave totale të gjeneruara nga operacionet e naftës midis Qeverisë Shqiptare, shoqërisë Albpetrol, AKBN-së dhe shoqërive private të naftës. Interesi i Shtetit Shqiptar në PSA administrohet nga</p>

ana e qeverisë të cilat do të nxisin më tej ndërgjegjësimin dhe debatin rreth çështjeve të tilla si qëndrueshmëria e të ardhurave dhe varësia nga burimet. Këtu mund të bëjnë pjesë pritshmëritë për vitet e ardhshme në ciklin e buxhetit në lidhje me prodhimin e projektuar, çmimet e mallrave dhe parashikimet e të ardhurave nga industrinë nxjerrëse si dhe përqindja e të ardhurave fiskale që pritet të vijë nga sektori nxjerrës.

Albpetrol dhe AKBN, të cilat marrin nga PSA-të: bonuse, pjesë nga prodhimi i naftës dhe të ardhurave të tjera që rrjedhin nga mos-zbatimi i termave të kontratave si gjoha dhe garanci të ekzekutuara.

MIE publikon informacion financiar lidhur me shpenzimet sipas natyrës dhe programit në faqen e saj të internetit

<http://infrastruktura.gov.al/>

2. Kërkesa EITI 4.4

Të ardhurat nga transporti

Të ardhurat e marra nga transporti i naftës, gazit dhe mineraleve kur këto përbëjnë zërat më të mëdha të të ardhurave në sektorin nxjerrës. Të dhënat e publikuara duhet të ndahen në nivel të barabartë me e zërat e të ardhurave dhe pagesave të tjera të raportuara (Kërkesa 4.7.). Vendet implementuese duhet të deklarojnë:

i. Një përshkrim të marrëveshjeve të transportit, përfshirë: produktin, itinerarin e transportit; kompanitë përkatëse dhe subjektet qeveritare, së bashku me NSH-të e përfshira në transport. ii. Përcaktimet e taksave, tarifave ose pagesave të tjera të rëndësishme të transportit, si dhe metodologjitë e përdorura për llogaritjen e tyre. iii. Publikimin e tarifave dhe vëllimit të mallrave të transportuar. iv. Deklarimin e të ardhurave të marra nga subjektet qeveritare, NSH-të, lidhur me transportin e naftës, gazit dhe mineraleve. 29 v. Grupi i punës inkurajohet, kur kjo gjë është e mundur, të ngarkojë Administratorin e Pavarur me detyrën e rakordimit të pagesave dhe të të ardhurave materiale që lidhen me transportin e naftës, gazit dhe mineraleve.


Shteti Shqiptar nuk merr taksë tranziti. Tubacionet e Albpetrol nuk janë funksionale.

Dy tubacione për transportin e naftës së papërpunuar lidhin terminalin e naftës së ARMOs në Vlorë me rafineritë e Fierit dhe Ballshit si dhe dy rafineritë mes tyre. Të dy tubacionet janë jashtë funksionit për shkak të vjetërimit. Në total, rrjeti i tubacioneve të naftës ka një gjatësi prej 188 km dhe kapacitet prej 2.5 milion ton në vit.

Trans Adriatic Pipeline (TAP) AG është një bashkim i disa shoqërive ndërkombëtare themeluar me qëllim planifikimin, zhvillimin dhe ndërtimin e gazsjellësit natyror TAP. Qeveria shqiptare ka hyrë në bisedime me koncorciumin e TAP për vendosjen e një takse Tranziti. TAP është aktualisht kontribuesi më i madh i investimeve të huaja direkte në vend. Që nga fillimi i ndërtimit deri në fund të vitit 2016, TAP ka investuar rreth 1.5 miliardë euro, nga këto 1 miliard euro janë investuar në 2016. Siç është vendosur në Marrëveshjen e Qeverisë Pritëse midis TAP dhe Qeverisë Shqiptare, TAP do të shpenzojë 14 milionë euro në infrastrukturë dhe investime të tjera në dobi të shoqërisë civile dhe komuniteteve.

Ionian Adriatic Pipeline (Projekti IAP)

Qeveria Shqiptare ka promovuar mundësinë e realizimit të projektit Adriatic Pipeline (IAP), me qëllim që të krijojë Infrastrukturën e përbashkët Rajonale për të shfrytëzuar gazin Kaspik në tregjet e vendeve si Shqipëria, Mali i Zi, Kroacia



	<p>Jugore dhe Bosnjë-Hercegovina. Projekti IAP përbën një pjesë të rëndësishme strategjike të rrjetit shpërndarës të gazit në Shqipëri, për shkak të rrugës së planifikuar dhe kapacitetit transportues.</p> <p>Infrastruktura e gazit në Shqipëri</p> <p>Qeveria Shqiptare miratoi ligjin për sektorin e gazit natyror Nr.102 / 2015 "Për sektorin e gazit" në mars të vitit 2015. Ky ligj do të qeverisë zhvillimin e infrastrukturës për transmetimin dhe shpërndarjen e gazit në Shqipëri.</p> <p>Në vitin 2016, Qeveria themeloi Operatorin Shqiptar të Transmetimit të Gazit (Albgaz Sh.a.) dhe prezantoi draft master-planin për rrjetin e shpërndarjes së gazit. Ky studim kushtoi rreth 1.1 milion euro dhe u financua nga BE.</p> <p>Drafti i master-planit analizon përdorimin e gazit në industri, transport dhe konsumatorët familjarë etj. TAP do të jetë burimi kryesor i furnizimit me gaz, ndjekur nga Ionian-Adriatic Pipeline (IAP) dhe rezerva të tjera potenciale të vendit. Drafti konsideron mundësinë e lidhjes së Kosovës dhe Maqedonisë me rrjetin Shqiptar të shpërndarjes së gazit. Gjithashtu, plani konsideron dhe mundësinë e depozitimit të gazit në nëntokën e Divjakës, në Dumre.</p> <p>Sipas studimit, konsumi vendas i gazit parashikohet të jetë rreth 2,167 milion m³ në vitin 2040 (duke përfshirë bujqësinë dhe transportin). Në të njëjtin vit, përdorimi potencial i gazit për prodhimin e energjisë elektrike vlerësohet të jetë rreth 770 milion m³, ndërsa përdorimi potencial i gazit në proceset e rafinerimit të naftës parashikohet të jetë 89 milion m³.</p>
<p>3. Kërkesa EITI 6.1</p> <p>Shpenzimet e kompanive nxjerrëse për qëllime sociale</p> <p>a) Në rastet kur shpenzimet e kompanive për qëllime sociale janë të përcaktuara me ligj apo nga kontrata me qeverinë e cila rregullon investimet nxjerrëse, kërkohet që vendet zbatuese të bëjnë deklarinimin dhe, kur është e mundur, rakordimin e transaksioneve të tilla. Kur këto përfitime ofrohen në natyrë, është e</p>	<p>Shpenzimet sociale janë shpenzime materiale të bëra nga kompanitë në sektorin e Industrive Nxjerrëse në dobi të publikut dhe shoqërisë civile, siç është mandatuar me ligj ose me kontratën me qeverinë.</p> <p>Qeveria dhe kompanitë e naftës të përfshira në sektorin e naftës informuan se aktualisht Marrëveshjet në fuqi të naftës nuk përfshijnë pagesa sociale të detyrueshme që duhet të kryhen nga kompanitë e naftës në dobi të komuniteteve.</p> <p>Koha dhe shuma e pagesave sociale vendosen</p>

nevojshme që vendet zbatuese të deklarojnë natyrën dhe vlerën e gjykuar të transaksionit në natyrë. Në rast se përfituesi i shpenzimeve sociale është një palë e tretë, dmth një agjenci joqeveritare, kërkohet që të bëhet publike emri dhe funksioni i përfituesit. Kur rakordimi nuk është i mundshëm, vendet duhet të paraqesin deklarata të njëanshme të këtyre transaksioneve nga kompanitë dhe/ose qeveria. b) Në rast se grupi ndërinstitucional i punës bie dakord se shpenzimet dhe transfertat sociale diskrecionale kanë natyrë materiale, grupi i punës duhet të krijojë një proces raportimi që synon arritjen e transparences në përputhje me pagesat dhe të hyrat e tjera për subjektet qeveritare. Në rastet kur rakordimi i transaksioneve kyçe nuk është i mundur, psh, kur pagesat e kompanive janë në natyrë ose ndaj një pale të tretë joqeveritare, grupi i punës mund të bjerë dakord për deklarim vullnetar e të njëanshëm nga ana e kompanive dhe /ose qeveria.

nga kompanitë e naftës në diskrecionin e tyre. Shoqëritë duhet t'i paraqesin këto shpenzime për AKBN/ Albpetrol për miratim si pjesë e miratimit vjetor të buxhetit.

4. Kërkesa EITI 5.2

Transfertat lokale

a) Kur transfertat ndërmjet njërive të qeverisë qendrore dhe lokale lidhen me të ardhurat e gjeneruara nga industria nxjerrëse dhe janë të përcaktuara nga kushtetuta, statuti apo mekanizma të tjera për shpërndarjen e të ardhurave, grupi i punës duhet të sigurojë deklarimin e transfertave materiale. Vendet zbatuese duhet të bëjnë gjithashtu të njohur edhe formulën e shpërndarjes së të ardhurave, në rast se ka, si dhe çdo mospërputhje ndërmjet shumës

Ministria e Financave dhe Ekonomisë është në proces përmirësimi të procedurave në mënyrë që të sigurohet për saktësinë dhe plotësinë e shpërndarjes së rentës në përputhje me kërkesat e reja ligjore. Sipas ndryshimeve të bëra, gjatë vitit 2015 NJQV-të kanë të drejtë të marrin 5% të rentës minerare të gjeneruara nga Shoqëritë që prodhojnë në zonën e tyre pa marrë parasysh ndonjë transferim të parashikuar në përputhje me ligjin e buxhetit vjetor. Udhëzim Nr.26, datë 4.9.2008 "Për taksat kombëtare", i ndryshuar përcakton procedurat rakorduese për alokimin e rentës minerar. Sipas këtij udhëzimi, NJQV-të në duhet të kryejnë rakordimet me drejtoritë rajonale të tatimeve dhe doganave në fund të cdo muaji dhe të nisin këto rakordime pranë

së transfertës të llogaritur sipas formulës përkatëse për shpërndarjen e të ardhurave dhe shumës aktuale të transferuar midis njësive të pushtetit qendror dhe atij lokal. Grupi i punës ka për detyrë të kryejë rakordimin e këtyre transfertave. Në rast se ekzistojnë barriera kushtetuese ose thelbësore ndaj pjesëmarrjes së njësive të qeverisë lokale, grupi i punës mund të kërkojë zbatim të përshtatur në përputhje me Kërkesën 8.1. b) Grupi i punës duhet të garantojë deklarin, dhe nëse është e mundur rakordimin, e të gjitha transfertave materiale diskrecionare ose ad-hoc.

Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit në Ministrinë e Financave. Njëkohësisht drejtoritë rajonale të tatimeve dhe doganave duhet të dergojnë brenda muajit informacion analitik për rentën e mbledhur dhe NJQV-të përfituese. Mbi bazën e rakordimeve Ministria e financave kryen transfertat e rentës NJQV-ve përfituese në muajin pasardhës.

Për shoqëritë e naftës, veprimtaria e të cilave shtrihet në disa NJQV njëkohësisht, udhëzimi përcakton përqindjen e rentës që do t'i shkojë çdo NJQV-je në varësi të vendburimit ku është prodhuar nafta apo gazi i shitur

5. Kërkesa EITI 2.5

Pronarët përfitues

a). Rekomandohet që vendet zbatuese të mbajnë një regjistër publik të pronarëve përfitues të korporatave që marrin pjesë në tender, operojnë apo investojnë në asetet e industrisë nxjerrëse, përfshirë identitetin e tyre, nivelin e pronësisë si dhe të dhënat mbi ushtrimin e kontrollit ose të pronësisë. Në rastet kur është e mundur, ky informacion duhet të përfshihet edhe në dokumentet ekzistuese që kompanitë kanë depozituar pranë autoriteteve rregullatore të korporatave, në bursë apo tek agjencitë e lincimit. Në rastet kur ky informacion është aktualisht i disponueshëm publikisht, Raporti EITI duhet të përmbajë udhëzime për mënyrën e aksesit në të. b) Është e nevojshme që: i. Raporti EITI të përmbajë informacion mbi

Në kontekstin e legjislacionit shqiptar "Pronar përfitues"¹ perkufizohet në Ligji nr.9917, datë 19.5.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", i ndryshuar, neni 2 / pika 12. si personi fizik, që zotëron ose kontrollon i fundit një klient dhe/ose personi, për llogari të të cilit kryhet një transaksion. Këtu përfshihen edhe ata persona, të cilët ushtrojnë kontrollin e fundit efektiv ndaj një personi juridik. Kontroll i fundit efektiv është marrëdhënia, në të cilën një person:

- a) zotëron në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të paktën 25 për qind të aksioneve ose të votave të një personi juridik;
- b) i vetëm zotëron të paktën 25 për qind të votave të një personi juridik në bazë të një marrëveshjeje me ortakët ose me aksionarët e tjerë;
- c) përcakton de facto vendimet e marra nga personi juridik;
- d) kontrollon në çdo lloj mënyre zgjedhjen,


politikat e qeverisë dhe diskutimet e MSG -së në lidhje me deklarimin e pronarëve përfitues. Këtu duhet të përfshihen detaje mbi dispozitat ligjore përkatëse, praktikat aktuale të deklarimit si dhe të gjitha reformat e parashikuara apo në proces lidhur me deklarimin e pronësisë. ii. Që prej 1 Janarit, 2017, grupi i punës ka nisur publikimin e një udhërrëfyesi lidhur me deklarimin e pronësisë në përputhje me klauzolat (c) - (f) më poshtë. Në udhërrëfyes do të përcaktohen të gjitha piketat kryesore dhe afatet, ndërkohë që zbatimi i tij do të jetë objekt vlerësimi nga ana e MSG-së si pjesë e raportit të saj vjetor.

c) Prej 1 Janarit, 2020, duhet që vendet zbatuese të kërkojnë, dhe kompanitë të deklarojnë, informacione në lidhje me pronësinë që do të përfshihen në raportin EITI. Kjo vlen për ato korporata që marrin pjesë në tendera, operojnë apo investojnë në asete të industrisë nxjerrëse dhe ky informacion duhet të përfshijë identitetin e pronarit (pronarëve), nivelin e pronësisë si dhe detaje mbi ushtrimin e kontrollit ose të pronësisë. Çdo mangësi apo e metë në raportimin e informacionit mbi pronësinë e përfituesve duhet të deklarohet në Raportin EITI, sëbashku me emrat e subjekteve që nuk arritën të dorëzonin të gjithë ose një pjesë këtij informacioni. Në rast se ndonjë prej vendeve do të jetë duke u përballur me barriera kushtetuese ose thelbësore për zbatimin e kësaj kërkesë në 1 Janar 2020, atëherë ky vend mund të kërkojë zbatim të përshtatur në përputhje me Kërkesën 8.1. d) Informacioni lidhur me identitetin e pronarit përfitues duhet të përmbajë emrin e tij, kombësinë

emërimin dhe largimin e shumicës së administratorëve të personit juridik.

Ky ligj përkufizon gjithashtu "Personat e ekspozuar politikisht" si personat, të cilët janë të detyruar të bëjnë deklarimin e pasurive të tyre, në përputhje me ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", përfshirë anëtarët e familjes apo personat e lidhur në marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi, me përjashtim të nëpunësve të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues, sipas përcaktimeve të legjislacionit për shërbimin civil. Në këtë kategori përfshihen edhe individët, të cilët kanë pasur ose kanë funksione të rëndësishme në një qeveri dhe/ose në një shtet të huaj, si: kryetar shteti dhe/ose qeverie, politikanë të lartë, zyrtarë të lartë të qeverisë, të gjykatave ose të ushtrisë, drejtues të lartë të kompanive shtetërore, zyrtarë të rëndësishëm të partive politike, përfshirë anëtarët e familjes apo personat e lidhur në marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi."

Në kuadrin e përpilimit të raportit EITI 2015, MSG i kërkoji subjekteve raportuese dhe autoritetit kontaktues, MEI-it të raportojë informacion për pronarët e dobishëm sipas perkufizimeve të standartit EITI. MEI konfirmon se sot Ministria nuk disponon një regjistër sipas kërkesave të standartit EITI. Subjektet e licensuara gjithashtu nuk ishin gati për këtë raportim. Shumica e subjekteve zgjodhi të mos e plotësoj formularin duke komentuar se pronësia mbi shoqërinë paraqitej në regjistrin e QKR. Një pjesë e mirë e tyre u shprehën se nuk kishte detaje të zinxhirit të plotë të pronësisë. Vetëm 17 raportuan pronarët e shoqërisë. Në të gjitha rastet pronarët e listuar ishin të njëjtë me çfarë ishte paraqitur në qëndrën kombëtare të regjistrimit



dhe vendbanimin, si dhe identifikimin e personave të ekspozuar politikisht. Gjithashtu rekomandohet deklarimi i numrit të kartës së identitetit, datëlindja, adresa e banimit apo shërbimit, si dhe mënyrat e kontaktit.

e) Grupi i punës duhet të miratojë një qasje që garanton saktësinë e informacionit të paraqitur nga kompanitë pjesëmarrëse. Kjo mund të kërkojë që kompanitë të vërtetojnë deklaratën e pronësisë përmes nënshkrimit nga një drejtues i nivelit të lartë apo këshilltar i lartë ligjor, ose të dorëzojnë dokumentacion mbështetës.

f) Përkufizimi i pronarit përfitues: i. Pronar përfitues në lidhje me një kompani do të thotë personi (at) fizik i cili direkt ose indirekt zotëron ose kontrollon korporatën.

ii. Grupi i punës duhet të bjerë dakord në lidhje me përkufizimin e duhur të termit pronar përfitues. Përkufizimi duhet të jetë në linjë me pikat (f) dhe (i) më sipër si dhe të marrë në konsideratë normat ndërkombëtare dhe ligjet kombëtare përkatëse, si dhe duhet të përfshijë pragun e pronësisë (s). Përkufizimi duhet të përcaktojë detyrimet për raportim për personat e ekspozuar politikisht.

iii. Kompanitë e listuara publikisht, përfshirë filialet në pronësi të plotë, duhet të bëjnë të ditur emrin e bursës si dhe linkun e bursës ku ato janë të listuara.

iv. Në rastin e ndërmarrjeve të përbashkëta (joint ventures), secili prej subjekteve pjesëmarrës duhet të deklarojë pronarin (ët) e tij, përveç rasteve kur subjektet janë të listuara publikisht ose janë filiale në pronësi të plotë të një kompanie të listuar publikisht. Secili subjekt është përgjegjës për saktësinë e informacionit të ofruar.

g) Raporti EITI duhet të përmbajë

gjithashtu informacion mbi pjesën e pronësisë së këtyre kompanive.

6. Kërkesa EITI 2.4

Kontratat


a) Vëndet zbatuese duhet të bëjnë publike të gjitha kontratat dhe licencat që përmbajnë kushtet për shfrytëzimin e naftës, gazit dhe mineraleve.

b) Është e nevojshme që Raporti EITI të përmbajë informacion mbi politikat e qeverisë në lidhje me bërjen publike të kontratave dhe licencave që rregullojnë kërkimin dhe shfrytëzimin e naftës, gazit dhe mineraleve. Këtu duhet të përfshihen detaje mbi dispozitat ligjore përkatëse, praktikat aktuale të deklarimit si dhe të gjitha reformat e parashikuara apo në proces.


Kur është e zbatueshme, Raporti EITI duhet të ofrojë një pasqyrë të kontratave dhe licencave që janë publikisht të disponueshme, si dhe të përmbajë një referencë ose linkun ku ato janë publikuar. c) Termi kontratë në 2.4 (a) do të thotë: i. Teksti i plotë i çdo kontrate, koncesioni, marrëveshje për ndarje prodhimi apo cdo marrëveshje tjetër të lidhur nga ana e qeverisë, e cila përmban kushtet lidhur me shfrytëzimin e gazit, naftës dhe rezervave minerare. ii. Teksti i plotë i çdo aneksi, shtojce ose pike i cili përcakton detajet lidhur me të drejtat e shfrytëzimit të përshkruara në 2.4 (c) (i) ose ekzekutimin e tyre. iii. Teksti i plotë i çdo ndryshimi ose amendamenti në dokumentet e përshkruara në 2.4 (c) (i) dhe 2.4 (c) (ii). d) Termi licencë në 2.4 (a) do të thotë: i. Teksti i plotë i çdo licence,

Kontratrat nuk bëhen publike në mënyrë integrale për arsye konfidencialiteti. Draft ligji për EITI-n propozon bërjen publike të kontratave. Të gjitha kontratat e konçensionit janë firmosur nga Ministri i Energjisë dhe Industrisë në kapacitetin e autoritetit kontraktues nga Këshilli i Ministrave. Pas nënshkrimit të kontratës, operatori harton planin e detajuar të zbatimit. Përpara miratimit, ky plan i nënshtrohet përsëri oponentëve teknikë shtetërore.


Ndërtimi i hidrocentraleve energjetike është subjekt i 10 deri në 20 lejeve dhe lejeve nga organe të ndryshme rregullatore, duke përfshirë: lejen mjedisore (vjetore), lejet për ndërtimin (para ndërtimit), leje për përdorimin e burimeve ujore (vjetore), licensë për prodhimin e energjisë (para fillimit të prodhimit), lejen për lidhjen me rrjetin e transmetimit të energjisë etj.



<p>kontratë qiraje, titulli apo leje përmes së cilës qeveria i jep kompanisë (ve) ose individit (individëve) të drejta për shfrytëzimin e naftës, gazit dhe/ose burimet minerare. ii. Teksti i plotë i çdo aneksi, shtojce ose pike që përcakton detajet lidhur me të drejtat e shfrytëzimit të përshkruara në 2.4 (d) (i) ose ekzekutimin e tyre. ii. Teksti i plotë i çdo ndryshimi ose amendamenti në dokumentet e përshkruara në 2.4 (d) (i) dhe 2.4 (d) (ii).</p>	
--	--




Përmbledhje e përgjigjeve të MSG për rekomandimet nga rakordimi dhe validimi, nëse është e aplikueshme




Rekomandimet e Raportit EITI 2015 janë diskutuar në MSG si më poshtë:

Gjatë vitit 2017 janë diskutuar vazhdimisht në MSG konkluzionet paraprake të dala nga procesi i Validimit si dhe Raportet paraprake që janë dërguar nga grupi i Validimit dhe Draft Raporti Paraprak i tij. Janë kërkuar nga MSG-së komente mbi konkluzionet e nxjerra nga Validuesi i Pavaruar.

Ndonjë pikë e fortë ose dobësitë e identifikuara në proçesin EITI



1. Pikë e fortë e në implementimin e EITI-t në Shqipëri është përfshirja e Hidroenergjisë në Raportet EITI, një risi kjo që shkon përtej kërkesave të detyrueshme të Standartit EITI.
2. Për tu mbajtur parasysh është se Shqipëria është i vetmi vend në rajon i cili është pjesë e Nismës EITI edhe e implementon atë me sukses prej vitesh.
3. Për tu përmendur si një arritje shumë pozitive është që, gjatë Procesit të Validimit të kryer gjatë vitit 2017 Shqipëria u vlerësua me Progres Domethënës në Implementimin e EITI-t.



4. Një tjetër arritje pozitive gjatë vitit 2017, është draftimi i Ligjit për Transparencën dhe kalimi i tij për miratim në Institucionet përkatëse.

Si pika të dobëta mund të përmendim:

1. Mosraportimi në kohë nga ana e bizneseve dhe nga disa institucione për Raportin EITI.
2. Mungesa e mekanizmave ligjore shtrënguese për shoqëritë e industrisë nxjerrëse të cilat nuk raportojnë brenda afateve për Raportin EITI.

Kostoja totale e implementimit




Gjatë vitit 2017, Sekretariati Kombëtar EITI u financua nga Buxheti i Shtetit në vlerën 16.000.000 Lekë. Projekti Grand TFA01769 i Bankës Botërore vazhdoi përgjatë vitit 2017, ku u disbursuan 285.959 USD nga të cilat u shpenzuan 224.624 USD, pagesa të bëra për Konsulencë, Raportin EITI 2016, Shpenzime operative dhe trajnime.

Fondi gjëndje nga Donator të tjerë (donacione të bëra nga Kompani që ushtrojnë aktivitetin e tyre në Industrinë Nxjerrëse, të bëra gjatë vitit 2014 për implementimin e EITI-t në Shqipërinë) u përdor për pagesën e konsulentit për mirëmbajtjen e website.


Më poshtë një informacion i detajuar për fondet e financuara për vitin 2017.

FONDET GJITHSEJ	PARASHIKIMI	REALIZIMI	%
A. Buxheti Shtetit	16,000,000 lekë	11,481,000 lekë	72
Pagat	8000,000 lekë	6,769,000 lekë	85
Sigurimet shoq. e shend.,TAP	3000,000 lekë	2,875,000 lekë	96
Shpenzime të tjera Operative	2,560,000 lekë	1,837,000 lekë	72



FONDET GJITHSEJ	PARASHIKIMI	REALIZIMI	%
Investim	2,440,000lekë	-	
B. Banka Botërore (TFOA1769)			
Në USD	-	224.624 USD	
Gjendje në fund vitit		64.150 USD	
C. Donatorë të tjerë			
a. Gjendja në fillim vitet	153,073 lekë	lekë	
Konsulencë për Mirëmbajtje web	-	124,488 lekë	
Shpenzime Operative		11.754 lekë	
Gjendje në fund vitit	-	16.831 lekë	

Është diskutuar veprimtaria e raportit përtej MSG-së



Veprimtaria e aktiviteteve vjetore 2017, është diskutuar në mbledhjet e EITI Albania MSG EITI, me kontribuesit dhe të angazhuarit në procesin EITI, Shoqërinë civile, kompanitë operuese në vend, me Pushtetin qendror dhe atë lokal dhe me banorët e zonave me aktivitet të industrisë nxjerrëse. Sekretariati Shqiptar EITI morri në konsideratë sygjerimet e ndryshme që erdhën nga secila palë e interesuar.

Për këtë referohu në seksionin "aktivitete të komunikimit" më sipër.



Detaje mbi antarësinë e MSG gjatë periudhës



Numri i anëtarëve të MSG për vitin 2017 ka qenë me katër (4) përfaqësues nga Shoqëria Civile, pesë (5) përfaqësues nga kompanitë nxjerrëse dhe shtatë (7) përfaqësues nga qeveria. Znj. Madlina Puka, përfaqësuese e shoqërisë civile, ka dhënë dorëheqjen nga detyra e saj funksionale në MSG-në e EITI Shqipëri në qershor të vitit 2016 . Vendi i saj në EITI Albania MSG mbetet akoma dhe sot vakant, pavarësisht kërkesave të përsëritura nga ana e Sekretariatit për zëvendësimin e saj.

Theksojmë që në çdo takim të MSG-së njoftohen të gjithë kontribuesit që kanë qenë pjesë e nismës EITI që në themelimin e saj ku dhe çdo sugjerim nga ana e tyre dëgjohet dhe merret në konsideratë.

Foto nga aktivitetet

